

# Porti i Durrësit, Port i Suksesshëm

## Porti i Durrësit, rritet volumi i mallrave dhe cilësia e shërbimeve



Eduard Ndreu, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Portual Durrës, prezanton sot rezultatet pozitive të Portit të Durrësit për vitin 2010 dhe fillimin e shkëlqyer të 2011.

“Stafi im dhe unë, jemi absolutisht të kënaqur nga rezultatet e parashikuara për vitin 2010, të cilat janë tejkaluar pothuajse në të gjitha fushat. Me një volum të mallrave të transportuara nga Porti i Durrësit prej 3.4 milionë ton, janë përpunuar në Port 0.3 milion ton mallra më shumë se në vitin 2009, një rritje prej 10%”, thekson Ndreu.

“Krizë globale, ekonomike dhe financiare e vitit 2009, ndikoi shumë në transportin ndërkombëtar të mallrave, por megjithatë Porti i Durrësit përballoi me sukses këtë periudhë edhe gjatë vitit 2010, duke arritur volume të kënaqshme.

E rëndësishme është që ndikimi i krizës në Portin e Durrësit ka qenë minimal në krahasim me Portet e tjera në Europë, Azi apo Amerikë dhe kjo si pasojë e një zhvillimi robust të ekonomisë tonë kombëtare. Fakt për këtë është rritja e konsiderueshme dhe më e madhe gjatë 15 viteve të fundit të eksportit shqiptar “Made in Albania” në krahasim me importin”, thekson Eduard Ndreu.

“Nisur nga të dhënat e deritanishme të ekonomisë tonë kombëtare, pritet që në Portin e Durrësit rritja e volumeve të arrijë rekordet e saj” shton Ndreu.

Për vitin 2011, Drejtori i Përgjithshëm i Portit të Durrësit, parashikon që zhvillimi i ekonomisë së jashtme të rajonit të Mesdheut dhe Europës në kombinacion me rritjen e qëndrueshme dhe të shpejtë të ekonomisë shqiptare, do të çojë në një rritje të lartë të volumeve në Portin universal të Durrësit.

Gjithashtu, këtu duhet të shtoj që Kina, si një partner shumë i rëndësishëm në transportin e mallrave nga Porti i Durrësit si në konteinerë por edhe në minerale, po luan një rol të madh në ngritje të volumeve si gjatë vitit 2010 por edhe në vazhdim.

Por jo vetëm rritja e kërkesës si pasojë e zhvillimit pozitiv dhe rritjes ekonomike ka ndikuar në rritjen e transportit. Porti i Durrësit është kthyer në vetvete në një port konkurrues nëpërmjet zhvillimit të infrastruktures dhe performancës në fushën e shërbimit duke fituar klientë të rinj dhe duke u pozicionuar qëndrueshëm në rajon.

# Porti Durrësit drejt zhvillimit



Foto: Porti i Durrësit, rritet madhësia e anijeve.

“Ne kemi shumë arsye dhe kemi një bazament të fortë për ti parë sfidat tona të tanishme dhe të ardhshme me shumë optimizëm dhe siguri”, thekson Ndreu.

“Përfitoj nga rasti të falenderoj jo vetëm klientët tanë të cilët na besuan sinqerisht, por edhe të gjithë stafin dhe punonjësit e Portit, të cilët me aftësitë, dëshirën, angazhimin dhe njohuritë e tyre, zhvilluan dhe zhvillojnë Portin çdo ditë”.

## Një pamje e përgjithshme e një Porti të suksesshëm

### Transporti me Konteiner

Import-Eksporti i Konteinerëve për vitin 2010 ka pasur një rritje modeste në lidhje me sasinë e TEU (twenty-foot equivalent unit) nga 68,222 TEU në vitin 2009 në 71,614 TEU në 2010.



Foto: Terminali i Konteinerëve Durrës “non stop working”

# Porti Durrësit drejt zhvillimit

E rëndësishme dhe tepër inkurajuese është rritja e tonazhit të përpunuar me konteinerë nga 797,756 ton në 2009, në 968,501 ton në 2010. Në këto të dhëna, pozitive është rritja e eksportit nga 293,631 ton në 2009, në 460,823 ton në 2010. “Me këtë, ne largohemi nga transporti me një drejtim dhe hymë në një bilanc import-eksport të balancuar”. Rritja e eksportit të mallrave me transportin në konteinerë, flet për një zhvillim dhe pranim të terminalit të konteinerëve në Portin e Durrësit si një qendër e rëndësishme në rajon”, shpjegon Ndreu.

## Trafiku i mallrave rifuxho dhe gjenerale

“Për tu vlerësuar më shumë”, tha Ndreu, “është rritja e dukshme në tonazhin e përpunuar të mallrave për eksport. Përqindja e mallrave të eksportit, në raport me totalin e mallrave (pa konteinerët), tregon një rritje nga 121,583 ton ose 7.37 %, në vitin 2009, në 581,960 ton ose 34.18 % në vitin 2010. Ne jemi të bindur që brenda një periudhe të shkurtër, tonazhi i importit dhe eksportit që ne përpunojmë të balancohet”.



“Kjo është e rëndësishme jo vetëm për portin, por për ekonominë shqiptare në përgjithësi, sepse forcon konkurrencën tonë ekonomike në tregjet globale. Hap vende të reja pune dhe ne fitojmë të ardhura në valutë duke forcuar fuqinë tonë blerëse të produkteve të huaja. Rritja e transportit të mallrave të eksportit made in albania është kryesisht rezultat i rritjes së volumit të çimentos dhe mineraleve, drejt tregjeve të huaja”, shtoi Ndreu.

## Trafiku i Pasagjerëve dhe Trageteve

“Në lidhje me trafikun e trageteve, Porti i Durrësit rriti sasinë e mallrave të eksportit”, shpjegon Eduard Ndreu. “Në 2009, nëpërmjet trageteve që akostuan në port, eksportuam 246,531 ton. Në 2010, eksportuam 272,605 ton. Në total, trafiku i trageteve u rrit nga 673,080 ton në 730,690 ton në vitin 2010, një rritje pothuajse 9%. Kështu sasia e mallrave të eksportit të transportuara me tragete është rreth 37.31% në 2010 kundrejt 36.63% në 2009”.




Foto: Terminali i Trageteve Durrës

# Porti Durrësit drejt zhvillimit

“Fatkeqsisht, trafiku i pasagjerëve shënon një rënie të vogël në 2010, krahasuar me vitin paraardhës. 834,040 pasagjerë kanë përdorur fasilitetet tona në vitin 2010, krahasuar me 876,026 pasagjerë në 2009. Kjo rënie e vogël u verejt në trafikun e pasagjerëve si në hyrje por edhe në dalje nga Shqipëria. Kjo mund të ketë ndodhur si pasojë e krizës financiare që kaloi Europa, e cila mund ti ketë bërë njerëzit më të kujdesshëm në shpenzimin e parave për pushime dhe udhëtime. Megjithatë, me liberalizimin e vizave nga Bashkimi Europian dhe me përfundimin e rikonstruksionit të terminalit të trageteve, unë besoj fort se do të ketë një rritje në trafikun e pasagjerëve në të ardhmen”, theksoi Ndreu.

## Performanca në Portin e Durrësit

Duke ardhur në pjesën tjetër të prezantimit të tij, Ndreu thotë: “jo vetëm lamë pas krizën dhe ishim në gjendje të rrisim trafikun portual në nivele më të larta se më parë, jo vetëm që njohëm një ringjallje të forcës sonë ekonomike duke hyrë fuqishëm me produktet tona në tregjet globale, por gjithashtu shohim sinjale pozitive dhe inkurajuese në lidhje me përmirësimin e performancës tonë.

Kemi kënaqësinë të dëshmojmë që performanca e portit tonë është rritur në mënyrë drastike. Kjo rritje në performancë bazohet në një numër të madh masash që kemi marrë dhe zbatuar, të cilat do të doja t'ua prezantoja shkurtimisht:

Të parën dhe më të rëndësishmen do të konsideroja dëshirën dhe aftësinë e stafit, kombinuar me optimizimin dhe besimin tek njëri tjetri. Përmes trainimeve, stimulimeve dhe përzgjedhjes së kujdesshme të personelit, kemi arritur të kemi një fuqi punëtore të cilësisë së lartë, kompetente dhe të motivuar, që kontribuon në mënyrë eficiente në arritjen e zhvillimeve të vazhdueshme në port.

Së dyti, do të përmend zhvillimin e sektorit privat dhe burimeve të tyre në ofrimin e shërbimeve në port. Ne tashmë kemi një alokim ekonomik shumë më të mirë të burimeve operationale në dhënien e shërbimeve që një port ofron për përdoruesit e tij.

Duke vazhduar, ne kemi ndërmarrë dhe implementuar një sërë projektesh, dhe po vazhdojmë, sidomos në lidhje me përmirësimin e përshtatshëm të infrastrukturës së portit. Ketu me lejoni t'ju shpreh që për herë të parë në historinë e saj, kalata lindore e Portit është pajisur me tre vinca portuale, komplet të rehabilituar, duke ofruar një performancë të lartë në Terminalin lindor të Portit të Durrësit

# Porti Durrësit drejt zhvillimit






Foto: Kalata Lindore Porti i Durrësit

Së fundi, ne kemi në implementim një numër të madh praktikash dhe procedurash administrative, teknike dhe operacionale moderne që na ndihmojnë të arrijmë objektivat tona.

Ndreu vazhdoi duke thënë: “më lejoni ta demonstroj atë që thashë duke ju shpjeguar disa shifra.



Në të dyja anët e portit, psh Terminali Perëndimor dhe Lindor, numri mesatar i tonëve për anije që kemi përpunuar në ditë është rritur ndjeshëm. Në terminalin Perëndimor kemi përpunuar mesatarisht 849 ton për anije në ditë në 2009. Në 2010 përpunam një mesatare prej 1,079 ton për anije në dite, me një rritje prej 230 ton për anije në ditë. Në Terminalin Lindor kemi përpunuar mesatarisht 1,003 ton për anije në ditë në 2009 dhe 1,594 ton për anije në ditë në 2010, me një rritje prej 591 ton për anije në ditë.




Kjo rritje në performancë është e suportuar gjithashtu nga një rritje e volumeve të mallit në cdo kalatë gjatë vitit, një shenjë e qartë se kalatat dhe burimet tona që lidhen me to, janë shfrytëzuar në mënyrë më ekonomike. Në Terminalin Perëndimor të portit kemi përpunuar 177,806 ton për kalatë në 2009 dhe 197,648 ton për kalatë në 2010, një rritje prej 19,842 ton

# Porti Durrësit drejt zhvillimit

për kalatë në vit. Në Terminalin Lindor kemi përpunuar 254,814 ton për kalatë në 2009 dhe 359,551 ton për kalatë në 2010, një rritje prej 104,737 ton për kalatë në vit.



Nisur nga performanca jonë e lartë, kemi qënë në gjendje të reduktojmë shkallën e zënies së kalatës nga 57% në 2009, në 50% në 2010 në Terminalin Perëndimor dhe nga 69% në 2009, në 62% në 2010 në Terminalin Lindor të portit”



# Porti Durrësit drejt zhvillimit

## Janar 2011, “BOOM” në Portin e Durrësit

Viti 2011 ka filluar dhe çfarë unë dua t’ju theksoj, shton Ndreu, është: “Muaji Janar paraqet një rritje të fortë në përpunimin e mallrave në Port në të gjithë terminalët, si në konteiner, mallra rifuxho dhe gjenerale, në trafikun Ro/Ro me tragete dhe në pasagjerë në krahasim me Janarin e një viti më parë.

<b>Terminali Perëndimor Durrës</b>	Janar 2010	Janar 2011	
<b>Ton Total</b>	50.055	69.308	138%
<b>Ton Eksport</b>	1.170	32.383	2768%
<b>Terminali Lindor Durrës</b>	Janar 2010	Janar 2011	
<b>Ton Total</b>	39.438	84.296	214%
<b>Ton Eksport</b>	3.704	61.966	1673%
<b>Terminali i Konteinerëve Durrës</b>	Janar 2010	Janar 2011	
<b>Ton Total</b>	83.403	105.000	126%
<b>Ton Eksport</b>	46.412	55.000	119%
<b>TEU Total</b>	5.984	8.413	141%
<b>Terminali i Trageteve Durrës</b>	Janar 2010	Janar 2011	
<b>Pasagjere</b>	70.673	73.637	104%
<b>Ton Total</b>	49.129	52.853	108%
<b>Ton Eksport</b>	19.868	23.174	117%
<b>Porti i Durrësit Total</b>	Janar 2010	Janar 2011	
<b>Ton Total</b>	222.025	311.457	140%
<b>Ton Eksport</b>	71.154	172.523	242%

Në Terminalin Perëndimor, volumi i mallrave është rritur nga 50,055 ton në janar 2010, në 69,309 ton në 2011, një rritje prej 38%. Eksporti në këtë periudhë është rritur nga 1,170 ton në 32,383 ton në këtë Terminal.

Në Terminalin Lindor volumi i mallrave është rritur nga 39,438 ton në janar 2010, në 84,296 ton në 2011, një rritje prej 114%. Eksporti në këtë periudhë është rritur nga 3,704 ton në 61,966 ton në këtë terminal.

Në Terminalin e Konteinerëve operacionet kanë një rritje nga 83,403 ton në janar të 2010, në 105,000 ton në Janar të 2011, një rritje prej 26%. Gjatë kësaj periudhe, pjesa e eksportit të mallrave u rrit nga 46,412 ton në janar 2010, në 55,000 ton në Janar të 2011, një rritje prej 19%. Në terma të volumeve TEU, kemi një rritje prej 41% nga 5,984 TEU në janar të 2010, në 8,413 TEU në janar të 2011.

“Gjithashtu edhe Terminali i pasagjerëve dhe Ro/Ro ka pasur rezultate të mira në Janar të 2011”. Trafiku i pasagjerëve është rritur nga 70,673 pasagjerë në janar 2010, në 73,637 pasagjerë në janar 2011, një rritje prej 4%.

Transporti Ro/Ro i mallrave është rritur nga 49,129 ton në janar të 2010, në 52,853 ton në janar 2011, një rritje prej 8%.

Pra, në përgjithësi, Porti i Durrësit ka përpunuar 222,025 ton mallra në janar të 2010 dhe 311,457 ton mallra në janar të 2011, një rritje prej 40%.

Ndërsa eksporti ka një rritje prej 142% nga 71,154 ton në janar të 2010, në 172,523 ton në janar të 2011.

# Porti Durrësit drejt zhvillimit

## Perspektiva dhe e ardhmja

Duke ardhur në fund të prezantimit të tij, Eduard Ndreu përmbledh: “Siç mund të shikohet edhe nga faktet të cilat unë i prezantova, Durrësi ka ruajtur pozicionin e tij të rëndësishëm si porti më i madh dhe universal i Shqipërisë. Kompetenca dhe aftësia jonë konkurruese e ka bërë Durrësin një port të përzgjedhur për linjat e Anijeve, për spedicionerët, agjentët dhe tregtarët. Rritja e volumeve të mallrave nga dita në ditë e sinkronizuar me rritjen e performancës tonë gjithashtu ka krijuar një arenë sadsfaksioni për ne dhe klientët tanë.

Ekonomia shqiptare tashmë është duke u rritur me një zhvillim të qëndrueshëm. Eksportet tona në rritje krijojnë vende të reja pune dhe rrisin të ardhurat e valutës së huaj. Edhe fqinjët tanë, si Kosova, po përdorin portin e Durrësit si porta e tyre kryesore detare. Suksesi i Qeverisë Shqiptare në përmbushje të kërkesave të BE, sidomos në realizimin e liberalizimit të vizeve, ka dhënë impaktin e tij pozitiv në Port, në rritjen e trafikut të pasagjerëve.

Projektet që ne kemi implementuar janë duke dhënë rezultatet e tyre pozitive dhe ato që ne jemi duke zbatuar, si thellimi i Portit, do te kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm në ekonominë e shkallës, duke e bërë Portin e Durrësit më konkurrues.

Në qoftë se ne do të vazhdojmë siç kemi punuar deri tani, **“E ardhmja është e jona”** përfundon Eduard Ndreu deklaratën e tij.

Këtë Artikull mund ta lexoni:

[www.apdurrres.com.al](http://www.apdurrres.com.al)